



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:038631

Datë: 25.09.2024

Numri i dokumentit: 06209957

C-III – 15 – 0252

Paditës: Z D I, J D I, S S I, dhe M S I të përfaqësuar Z I e këtë e përfaqëson me autorizim avokate D K nga Prishtina .

Kundër

Të paditurëve: NSH „ Ratar ” përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Rr. „Driton Hoxha” nr. 55, përfaqësuar nga N K.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar, i përbërë nga Hasim Sogojeva, Gjyqtar Kryesues, Gjyqtarët anëtar Murat Hulaj dhe Asllan Krasniqi, në seancën vendimmarrëse më dt. 25 shtator 2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa / kërkesa e paditësve Z D I, J D I, S S I, dhe M S I, kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit për NSH „ Ratar ” PRN 115-0325, dt. 02.04.2015.

II. Secila palë i heq shpenzimet e veta të procedurës .

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 12.05.2025, është ushtruar ankesa e paditësve kundër të paditurit në DHPGJS, në lidhje me Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL) për NSH „Ratar ” PRN 115- 0325, me të cilin është refuzuar kërkesa pronësore, në ngastrën nr., në vendin e quajtur „V ” ZK Prishtinë.

Në parastresë të ankesës që është hartuar nga avokati B J është deklaruar se kërkesa është refuzuar nga AL me arsyetim të mungesës së dokumentacionit, që është një qëndrim i pasakt, nga shkaku se tërë dokumentacioni relevant ju është dorëzuar më dt. 12.03.2015, Autoritetit të Likuidimit dhe si pasoj e mos vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike ka vërtetuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale .

Paditësit me parashtrësë dt. 14.05.2015, kanë theksuar se më dt. 10.04.1964, me Aktvendim për Arondim nr. 30/63, është kryer arondimi i tokave ndërmjet pronarit KBI „Kosova Export” nga Fushë Kosova dhe pronarit tani të ndjerit T I, nga Ç paraardhësit të paditësve me të cilin aktvendim paraardhësit ju është marrë ngastra nr. dhe ., ZK Ç , ndërsa si ndërrim ju është dhënë ngastra nr. , ZK Prishtinë me sipërfaqe 1,31.29ha. Ky ndërrim është kryer faktikisht në momentin e marrjes së aktvendimit dhe tokën e marrë nga KBI, babai im e ka punuar deri në momentin e vdekjes dhe pas vdekjes tani e punojnë trashëgimtarët ligjor.

Neve na është dhënë pjesa e ngastrës ., me sipërfaqe, 1,31.29ha, ndërsa ajo ka pasur sipërfaqe të tërësishme 1,43,43ha, dhe KBI ka pasur për obligim të kryej ndarjen fizike dhe të na regjistroj të drejtën e pronësisë, për sipërfaqen 1,31.29ha por këtë nuk e ka bërë .

Gjatë kohës kur babai im ka qenë në jetë e ju ka drejtuar Gjeodezisë, me gjeodet ka dal në teren dhe ka bërë matjet gjeodezike të ngastrës ., por megjithatë ai ka vdekur dhe ngastra ka mbetur në emër të KBI-së .

Ka bashkangjitur :

- Kopjen e dokumentit identifikues për të ndjerin D. I,
- Vendimin e AL PRN 115- 0325 ,
- Aktvendimin e KBI „Kosova Export ” dt. 01.12.1963,
- Aktvendimin e Komisionit për Arondime të Kuvendit Komunal në Prishtinë, dt. 10.04.1964, me nr. 30/63,
- Flet e posedimit nr. 222, ZK Ç, ngastra nr. dhe . me sipërf. 1,53.44ha, dt.
- Fleta e Posedimit nr. 4143, ZK Ç., për ngastrën nr. ., me sipërfaqe 1,43,43ha.
- Kërkesa për ndryshim të operativ kadastral, dt. 09.05.1964, e ushtruar nga T. I. për KBI „Kosova Export ” ,
- Padija e paditësit KBI kundër të paditurit T I dt. 22.02.1971,
- Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 322/77, i pajisur me klauzolë të plotfuqishmërisë,
- Përgjigja e KBI „Kosova Export” për D I, dt. 11.09.2003,
- Aktvendim për zbatim të ndërrimeve i Komunës së Prishtinës, nr. 011- 2828, dt. 01.10.2003,
- Aktgjykim C. nr. 2157/03, i Gjykatës Komunale në Prishtinë dt.27.07.2004,
- Aktvendim i Gjykatës Suprem të Kosovës Rev 258/2006, me të cilin Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC 501/2005, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë C. 2157/2003, janë prishur ,
- Aktvendimi C. nr. 62/2009 i Gjykatës Komunale në Prishtinë me të cilën është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore ,
- Shkresa- përgjigja e Drejtorit të Urbanizimit Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Komunës së Prishtinës për AKP-në dt. 10.07.2009,
- Aktvendimi i Komunës së Prishtinës, 05- 952- 1-838, dt. 18.09.2009, për bartje të pronës 1831, ZK Ç në emër të T I
- Certifikata e pronës P- 71914059-01831-2, dt. 14.10.2013, në emër të I T,
- Kopja e Planit për ngastrën nr. 1831-2, dt. 14.10.2013,
- Aktvendimi për shqyrtim të trashëgimisë te noteri I A LRP ., dt., për shqyrtim të trashëgimisë së trashëgimlënësit T I sipas të cilit janë shpallur si trashëgimtar D I, S I dhe M I,
- Aktvendimi i Komunës së Prishtinës 011- 952- 1-1374, dt. 13. 02.2014,
- Kallëzimi Penal 31.10.2014,
- Njoftim nga prokuroria e Shtetit dt. 01.11.2014,

- Padi për konflikt administrativ lidhur me aktin administrativ të komunës së Prishtinës,
- Ankesë kundër Aktvendimit të DHPGJS SCC -10-0213.

Më dt. 02.11.2023, DHPGJS ka lëshuar urdhër për AKP-në, C-III- 15- 0252, me të cilin i ka kërkuar të jep përgjigje në ankesë kundër Vendimit të AL PRN 115- 0325.

Më dt. 24.11.2023, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj dorëzoi parashtrësën në mbrojtje ndaj ankesë së ushtruar kundër Vendimit të AL PRN 115- 0325, me propozim që ankesa të refuzohet

Në parashtrësë është deklaruar se NSH „Ratar ” është në procedurë të likuidimit prej dt. 11.08.2014, ndërsa më dt. 01.10.2014, paditësi ka dorëzuar kërkesë kreditore për të drejtën e pronësisë për ngastrën nr., në vendin quajtur „V ” ZK Prishtinë .

Më dt. 07.04.2015, AL mori Vendim PRN 115- 0325, me të cilin ka refuzuar kërkesën .

Vendimi është mbështetur në faktet dhe bazat ligjore në vijim :

- Neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, parashikon „elementet në vijim përbejnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e kërkesës apo interesit të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ... kërkesa apo pretendimi është i pasfatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme ” .

Në parashtrësë të mbrojtjes nuk ka dhënë sqarim dhe as kundërshtim, pasi procedura e likuidimit është zhvilluar nga AKP, për NSH „Ratar ” ndërsa ngastra objekt kërkesë – ngastra nr., ishte regjistruar në emër të KBI „Kosova Export ”.

Ka bashkangjitur :

- Vendimin e AL PRN 115- 0325, dt. 02.04.2015,
- Formularin e kërkesës kreditore,
- Aktvendimin për shqyrtimin e trashëgimisë për T I të marrë nga noteri I A dt. 18.10.2013,
- Aktvendimi i Komunës së Prishtinës 011- 952- 1-838, 09.10.2013,
- Aktvendimi dt. 18.09.2013, i Komunës së Prishtinës 011- 952- 1-838,
- Aktvendimi i Kuvendit Komunal në Prishtinë, Komisionit për Arondim, nr. 30, dt. 10.04.1964,
- Shkresa e AKP-së për Komunën e Prishtinës Drejtorin e Urbanizimit, 10.07.2009,
- Shkresa e AKP-së, dt. 23.02.2015, për D I për plotësim të kërkesës me dokumentacion ,
- Aktvendimin SCC -10-0213, dt. 23.04.2015, i DHPGJS, për aprovimin e masës së sigurimit ,
- Aktvendimi AC –I- 15- 0070, i kolegjit të Apelit i DHPGJS me të cilin ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së par,
- Aktgjykimi SCC- 10- 0213, dt. 04.10.2016,
- Certifikata dt. 01.11.2016, e lëshuar nga Kragujevci .
- Aktvendimi AC – I- 16- 0241, i Kolegjit të Apelit i DHPGJS, me të cilin është anuluar Aktgjykimi SCC- I0- 0213, dt. 04.10.2016.

Më dt. 05.03.2024, paditësit kanë dorëzuar parashtrësën në përgjigje të mbrojtjes së të paditurit.

Në parashtrësë është deklaruar për ekzistimin e legjitimitetit aktiv të paditësve duke theksuar se D I, ka vdekur më dt., që është djali i T I dhe me aktvendim të noterit E N në Graçanicë, është bërë shqyrtimi i trashëgimisë . Në parashtrësë është deklaruar se si trashëgimtar të T I janë nipërit, Z dhe J djemtë e D I, dhe S dhe M djemtë e S,

Me këtë parashtrësë Z I ka dorëzuar edhe autorizimin për përfaqësim të vërtetuar te noteri E N të dhen nga J I, S I dhe M I .

Ka dorëzuar edhe provat :

- Aktgjykim C. Nr. 322/77, të Gjykatës Komunale në Prishtinë,
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë AC 53/84,
- Raporti i ekspertit M V , dt. 01.07.1983,
- Kopja e Planit për ngastrën ..
- Fleta e Posedimit..., dt.,
- Fleta e Posedimit nr., dt.,
- Aktvendimi e Kuvendit Komunal në Prishtinë nr. 30/64, dt. 10.04.1964,
- Ekspertiza gjeodezike e ekspertit A A C. nr. 2157/03, viti 2004,
- Aktvendimi për shqyrtimin e trashëgimisë për trashëgimlënësin D I që ka vdekur më dt. 10.10.2022, te noteri E N më dt. 28.04.2023.

Më dt. 11.03.2024, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- III- 15- 0252 për paditësit dhe AKP-në me të cilin ka kërkuar të identifikohen ngastrat e ndërruara dhe posedimi i tyre.

Më dt. 20.03.2024, paditësit dorëzuan ekspertizën gjeodezike, të hartuar nga eksperti B V, nga Prishtina dt. 11.03.2024 .

Pas përfundimit të procedurës me shkrim, gjykata vendosi të mbaj seancë dëgjimore publike për dt. 09.07.2024, në të cilën për paditësit kanë prezantuar Z I dhe avokatja D K, ndërsa për të paditurin N K .

Paditësit përmes përfaqësuesit janë deklaruar : Paditësit janë njoftuar nga AKP-ja, më dt. 03.09.2014, se prona lëndore është në procedurë të likuidimit dhe te AL është ushtruar kërkesa për ngastrën nr., më dt., Në kërkesë janë bashkangjitur të gjitha provat që paditësit i kanë pasur në disponim dhe të njëjtat ja kemi dorëzuar edhe gjykatës. AL ka refuzuar kërkesën me pretendim se paditësit nuk e kanë regjistruar të drejtën e tyre të pronësisë në kadastrë në bazë të vendimit për arondim. Ka kërkuar të aprovohet ankesa kundër Vendimit të AL.

Për AKP-në përfaqësuesi është deklaruar : ka kundërshtuar pretendimet e paditësit dhe ka theksuar paditësit pretendojnë se e paditura është fajtores për mos regjistrim të drejtës së tyre, ky fakt është i pa besueshëm, dhe i pa argumentuar dhe të njëjtat kanë arritur ti vënë në lajthim gjykata për faktin se NSH – nuk është fajtores, pasi organi shtetëror sipas detyrës zyrtare ja ka dërguar Vendimin kadastrit . Ka propozuar të refuzohet kërkesa për anulim Vendimi.

Në seancë dëgjimore Gjykata ua dha mundësin palëve ndërgjyqës që parashtrësat me shkrim të fjalës përfundimtare, ti dorëzojnë në afatin prej 20 ditëve .

Më dt. 19.07.2024, paditësit dorëzuar parashtresën me të cilën janë deklaruar se mbesin pranë ankesës kundër Vendimit të AL dhe parashtresave të dorëzuara .

Me aktvendimin për arondim të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 30/64, dt. 10.04.1964, paraardhësit tonë T I ju janë marrë ngastrat nr. dhe, ZK Ç, me sipërfaqe 1,53.99ha, dhe ju është dhënë pjesa e ngastrës nr., ZK Prishtinë, me sipërfaqe 1,31.29ha. Marrjes së këtij aktvendimi i ka parapari aktvendimi për arondim nr. 1997/63, dt. 01.12.1963, i Drejtorisë së Kuvendit Komunal në Prishtinë sipas kërkesë që është ushtruar nga KBI „Kosova Export ” për arondim.

Komisioni për Arondim i Kuvendit Komunal në Prishtinë me aktvendim 30/64, dt. 10.04.1964, në vend të dy ngastrave kadastrale që ishin në procedurë të arondimit gabimisht ka përfshirë edhe ngastrën e tret nr., ZK Ç me sipërfaqe 0.24.43ha, që më vonë me Aktgjykim të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. 322/77, dt. 12.10.1983, kjo ngastër ju është kthyer paraardhësit të paditësve T I.

Në parashtresë është deklaruar se ngastrat e marra nga paraardhësi i paditësve janë regjistruar në emër të KBI „Kosova Export ”, ndërsa ngastra e dhënë për paraardhësin e paditësve nuk është regjistruar në emër të paraardhësit të paditësve, dhe ajo ka mbetur në emër të KBI „Kosova Export ”, nuk është bërë ndarja fizike ashtu që sipërfaqja 1,31.29ha të regjistrohet në emër të paraardhësit të paditësve.

Ndarja fizike e ngastrës nr., është kryer në vitin 2006, me kërkesën e ankuesit dhe sipas aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Prishtinë C. nr. 2157/03, që është formuar ngastra nr., dhe ngastra nr.. e cila ka sipërfaqe 1,31.29m2.

Më tej në parashtresë është deklaruar se Vendimi i AL, për NSH Ratar PRN 115- 0325, dt. 07.04.2015, është një vendim kundërtihënës dhe i pa qëndrueshëm për faktin se AL ka pasur në disponim tërë dokumentacionin dhe si dëshmi se KBI është regjistruar si pronar në kadastër për pronat e aronduara, ndërsa ankuesi nuk është regjistruar si pronarë dhe në rastin konkret nuk kërkohet kthimi i tokës, as vërtetimi i pronësisë ngase paditësit janë pronar dhe posedues në bazë të vendimit të organit shtetëror nr. 30/64 dt. 10.04.1964 .

Ka kërkuar të anulohet Vendimi i AL PRN 115- 0325, dt. 07.04.2015, dhe paditësit janë pronar Z, J I, S I dhe M I nga ¼ pjesë e ngastrës nr.. me sipërfaqe 13129 m2, ZK Prishtinë dhe obligohet Kadastri Komunal në Prishtinë ta regjistroj të drejtë e pronësisë sipas këtij aktvendimi .

Më dt. 24.07.2024, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj dorëzoi parashtresën në fjalën përfundimtare, duke kundërshtuar ankesën e ushtruar kundër Vendimit të AL .

Në parashtresë është deklaruar se paditësi ka bërë përpjekje ta bind gjykatën se e drejta në kërkesë është në anën e tij, por edhe në seancë dëgjimore publike të mbajtur, nuk ka dorëzuar asnjë provë për të argumentuar se aktvendimi për arondim nuk është zbatuar në mënyrë të plotë. Paraardhësi i paditësit ka qenë në vazhdimësi në procedurë gjyqësorë, por një fakt të tillë nuk e ka potencuar, Pas pranimit të shkresave të lëndes C. nr. 322/77, dt. 19.10.1983, kemi kuptuar se ekziston aktvendimi 30/63, dt. 24.01.1964, dhe për të njëjtat ngastra të paraardhësit të paditësit ka përfituar dy ngastra nr., dhe..

Lidhur me këto ngastra Zyra Regjionale e AKP-së, ka kërkuar historiatin mbi bazën e supozimit se ky aktvendim në procedurë administrative i nxjerr nga organi kompetent i vitit 1964, dhe i zbatueshëm sipas detyrës zyrtare, dhe nuk mund i njëjti të priset pasi nuk lejohet ankesë, por

vetëm propozimi për realizimin e kompensimit në gjykatë për shkak të dallimit të bonitetit të tokës. Pas disa muajve ky aktvendim si duket është zëvendësuar por pa u anuluar fare i njëjti. Me aktvendimin e ri nuk theksohet zëvendësim i aktvendimit paraprak , përveç me laps kimik në anën e djathtë zëvendësim. Bile edhe nënshkrimi i zyrtarit dallon nga teksti i nënshkrimit . Aktvendim zëvendësues në drejtësi nuk ekziston duke zëvendësuar një Vendim pa u abroguar vendimi tjetër i nxjerr më parë dhe duke zbatuar para disa muajsh .

Paditësi si prova ka ofruar vetëm historiatin e pronave të cilat i ka dhënë në emër të arondimit, ndërsa nuk sjell historianit e pronave që i kërkon . Përmbajtja e historiatit sqaron se bazuar në shënimet e kadastrit nga formimi i ekzistimit kanë ekzistuar ato deri në vitin 1996, e të cilat shënime janë dërguar në Serbi, vetëm në këtë situatë gjykata të bie në lajthim . Shih Certifikata nr., dt., në shkresa të lendes të përkthyer në shqip.

Çka ju ka dashur ky historiat nuk mund të kuptohet nga askush, por një është e vërtet se shumë lende janë në pritje për tu zgjedhur deri sa të kthehet dokumentacioni nga Serbia.

Për këtë arsye AKP, propozon të refuzohet ankesa. Ka dorëzuar Aktvendimin nr. 30/63, dt. 24.01.1964, sipas të cilit ju janë marre T I ngastrat nr. , , dhe , ndërsa ju janë dhënë ngastrat nr., dhe., në vendin e quajtur „V ” .

Në rastin konkret kemi të bëjmë me dy Vendime, me numër 30/63 dhe 30/64, i pari më dt. 24.01.1964 dhe i dyti më dt. 10.04.1964 .

Për shkak se AKP-ja ka dorëzuar Vendimin me nr. 30/63, dt. 24.01.1964, DHPGJS, më dt. 09.09.2024, ka lëshuar Urdhër për palët ndërgjyqës, duke i kërkuar paditësit të sqarohet se pse e ka heshtur ekzistimin e kësaj prove sikundër AKP-ja pse nuk e ka dorëzuar këtë provë me parashtrësë të mbrojtjes .

Më dt. 11.09.2024, përfaqësuesi i paditësve ka dorëzuar parashtrësën dhe është deklaruar se për shkak se nuk është arritur marrëveshja ndërmjet palëve për ndërrimin e pronave ashtu që nuk është pranuar oferta për ngastrat e ofruara për shkak të kualitetit të tokës dhe një vendim i tillë nuk është pranuar , por është pranuar më vonë kjo ofertë, kështu që vendimi i dytë është bërë i formës së prerë .

Ka dorëzuar Aktvendimin nr. 30/64, dt. 10.04.1964.

Më dt. 13.09.2024, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj është deklaruar me parashtrësë, duke dhënë arsyet se pse këtë provë e ka dorëzuar me fjalë përfundimtare , ashtu që ju është kërkuar Arhivës Nder komunale për ti kërkuar shkresat komplet të procedurales administrative për arondim të viti 1964.

Në parashtrësë është sqaruar për shkak të procedurave për sigurim dokumenti në Arkiv, kemi siguruar këtë provë, më dt. 09.07.2024.

Ka dorëzuar provën e shkresës dt. 19.06.2024, të hartuar nga AKP , për Arkivin.

Arsyvetimi Ligjor

Ankesa e paditësve kundër Vendimit të AL PRN 115- 0325, nuk është e bazuar

Gjykata pas përfundimit të procedurës me shkrim, në kuptim të nenit 42 të Ligjit nr. 06/L- 086, ka vendosur të mbaj një seancë dëgjimore publike , për dt. 09.07.2024 , për ti dhënë mundësi që secilës palë të deklarohej në pretendime të veta në lidhje me ankesës kundër Vendimit të AL PRN 115- 0325, me të cilën është refuzuar kërkesa pronësore në ngastrën nr., në vendin e quajtur „V” me sipërfaqe 13129m², ZK Prishtinë .

Në këtë raste gjykata ka respektuar parimin e barazisë së palëve në procedurë, për një gjykim të drejtë dhe të pa anshëm , duke ju dhënë mundësi të deklarohej për të gjitha provat që palët ndërgjyqës kanë dorëzuar.

Gjykata me rastin e vendosjes ka bërë vlerësimin e provave, dhe në bazë të provave të pranuar, ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Nuk është si kontestues fakti se paditësit, janë trashëgimtar ligjor të paraardhësit të tyre T I sipas aktvendimit të noterit I A LRP, dt., dhe janë shpallur si trashëgimtarë ligjor D I, S dhe M I Sipas këtij aktvendimi si objekt i pasurisë trashëgimore është përfshirë edhe ngastra lëndore ., ndërsa trashëgimtari ligjor /paditësi D I që ka vdekur, më dt., shqyrtimi i trashëgimisë është bërë te noteri E N në Graçanicë, më dt. 28.04.2023 dhe si trashëgimtar ligjor për D janë shpallur: Z I dhe J I . Me këto prova vërtetohet legjitimiteti aktiv i paditësve në kërkesë pronësore .

Nuk është kontestues fakti se paraardhësi i paditësit T I, kishte qenë pronarë i ngastrave kadastrale nr., me kulturë arë, klasa 5, me sipërfaqe 87.31ari, ngastrës nr., me kulturë, arë klasa 2, me sipërfaqe 24,43ar, dhe ngastra nr., me kulturë, arë klasa 4, me sipërfaqe 66.68ari, kjo sipas gjendej në kadastër në vitin 1954 deri në vitin 1964.

Nuk është kontestues fakti se bazuar në propozimin e KBI „Kosova Export ” në Prishtinë, nr. 7968, dt. 15.10.1963, për arondim të tokave bujqësore, në ZK Ç, Këshilli për Bujqësi dhe Pylltari i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, ka marrë Aktvendim nr. 19997, dt. 04.12.1963, me të cilin ka dhënë pëlqimin për KBI-në „Kosova Export ” për lejimin e arondimit, (ndërrimeve) të tokave bujqësore të KBI-së me T I për ngastrat nr., me sipërfaqe 78 ar, dhe ngastra nr., me sipërfaqe 87ar. Me këtë aktvendim nuk është caktuar se çka do ti jepet pronarit të tokës T I.

Me aktvendimin nr. 30/64 , dt. 10.04.1964, të Kuvendit Komunal Drejtoria për Ekonomi , Komisioni Për Arondime është lejuar arondimi i fondit të tokës bujqësore KBI „Kosova Export” , me pronarin T I ashtu që ngastrat nr.... dhe., ZK Ç. i merren të njëjtit dhe këto prona i jepen KBI „Kosova Export ” ndërsa KBI „Kosova Export ” –së, pronarit T I ja jepet ngastra nr. me sipërfaqe 1,31.29ha, ZK Prishtinë .

AKP-ja, përfaqësuesi i saj N K me fjalën përfundimtare ka dorëzuar provën e Aktvendimit të Kuvendit Komunal, Komisionit për Arondiem nr. 30/63, dt. 24.01.1964 sipas të cilit aktvendim ju janë marre T I ngastrat nr. , , dhe , ndërsa ju janë dhënë ngastrat nr., dhe, në vendin e quajtur „V ” .Këtë provë paditësit fare nuk e kanë dorëzuar, përkundrazi e kanë heshtur ekzistimin e këtij aktvendimi .

Ngastrat nr., me sipërfaqe 8731 m² dhe ngastra nr., me sipërfaqe 6613m², ose me sipërfaqe 1 53 44m², është e regjistruar në emër të KBI „ Kosova Export” nr. flet posedimi nr.. Ç .

Nuk është kontestuese fakti se për ngastrën nr., me sipërfaqe 24.43 ari është zhvilluar një kontest sipas padis së paditësit KBI, „Kosova Export ” sipas të cilës kontesti ka përfunduar duke ju njohur pronësia të paditurit T I me Aktgjykim C. nr. 322/77, dt. 12.10.1983.

Gjykata bazuar në raportin e ekspertit të gjeodezisë M V dt. 01.08.1983, C. nr. 322/77, me rastin e daljes në teren ka bërë identifikimin e ngastrës ., me sipërfaqe 2443m², në vendin e quajtur „ P. ” ka konstatuar se T Iu janë marrë ngastra nr. ., me sipërfaqe 6668m², dhe ngastra nr., me sipërfaqe 87,31 m², ose sipërfaqja 1 53 99ha, ndërsa për këtë ka marrë ngastrën nr., me kulturë ar, kla 3, me sipërfaqe 1 31 29ha. Eksperti ka nxjerr edhe kopjen e planit që ngastra., ka pasur sipërfaqe 1 43 43 ha, mirëpo kjo ngastër nuk ishte objekt i kontestit.

Po ashtu kjo ngastër është identifikuar si me raport me shkrim ashtu edhe me skicë të matjeve edhe nga gjeodeti A A për rastin C. nr. 2157/03, sipas kërkesë së Gjykatës Komunale në Prishtinë me të gjitha të dhënat gjeodezike .

Më dt. 01.10.2003, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi i Komunës së Prishtinës, me aktvendim 011 nr. 2828, dt. 01.10.2003, ka lejuar bartjen e pronës për ngastrën nr., në emër të T I, sikundër edhe në bazë të aktvendimit 05- 952- 1-838.

Bazuar në këto aktvendime është lëshuar Certifikata e pronës dhe kopja e planit për njësinë P- , më dt., si arë, klasa 3, bujqësore, me sipërfaqe 01.3129 ha, që kjo pronë është regjistruar në emër të T I. Kjo ngastër ka qenë e përfshirë si pasuri trashëgimore e trashëgimlënësit T I me rastin e shqyrtimit të trashëgimisë të noteri I A.

Më dt. 13.02.2014, Komuna e Prishtinës ka marrë aktvendim 011- 1374, dhe ka revokuar veprimet juridike lidhur me bartjen e ngastrën nr., me sipërfaqe 13129m², dhe gjendja në regjistër kadastral është kthyer në gjendje të mëparshme që ka qenë e regjistruar në emër të KBI „Kosova Export”. Ky vendim i Komunës së Prishtinës është marrë, bazuar në kërkesë të AKP-së.

Me provën e Vendimin të AL për NSH Ratar PRN 115- 032, dt. 12.04.2015, të AL , kërkesa e D I dhe e avokatit B J është refuzuar kërkesa pronësore që ka të bëjë me ngastrën nr., ZK Prishtinë , ndërsa vendimi është mbështetur në nenin 36.2.2 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, pastaj në nenin 268 të Ligjit për Punën e Bashkuar.

Me Urdhër të Gjykatës, paditësi ka bërë identifikimin me ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë B V, ngastrat kadastrale ., dhe ..

Sipas raportit të ekspertit dt. 11.03.2024, ngastra nr. 1831-0, është ndarë në dy pjesë – njësi kadastrale dhe janë krijuar ngastra nr. dhe ..

Në raport me shkrim eksperti konstatoi se njësia kadastrale nr., aktualisht ka sipërfaqe 1214m², në vendin e quajtur „V ” dhe e njëjta kufizohet nga pjesa veriore me ngastrën nr. ., dhe ., ZK Prishtinë që është rrugë e asfaltuar, në pjesën veriore kufizohet me tri ngastra dhe atë., ., dhe ., në pjesën jugore me dy ngastra, ., dh ., nga pjesa perëndimore me ngastrën nr..

Eksperti ka konstatuar, ngastra nr., që aktualisht është në emër të KBI „Kosova Export” e regjistruar sipas fletëparaqitjes Reg 161/2006, me sipërfaqe 13129m², me kulturë arë, klasa 3, vendi i quajtur „V” ZK Prishtinë kufizohet :

Nga Veriu me ngastrën nr. , ngastrën nr., me ngastrën nr., dhe., ZK Prishtinë .

Në pjesën Lindore, kufizohet me ngastrën nr.,

Nga pjesa Jugore kufizohet me ngastrat, ZK Ç,

Nga pjesën perëndimore kufizohet me ngastrën nr..

Aktualit në regjistër kadastral për këtë ngastër është regjistruar masa e sigurimit e lëshuar nga DHPGJS SCC – 1—0213, dt. 23.04.2015.

Eksperti për ngastrën kadastrale .. dhe., është deklaruar :

Ngastra nr., është parcilazuar në 44 njësi, ndërsa ngastra nr., aktualisht është bashkuar me ngastrën nr., dhe është në emër të kompanisë BP H V .

Në ekspertiza janë bashkangjitur edhe skicat e matjeve në të gjitha drejtimet .

Në lidhje me ekspertizën gjyqësore , asnjëra palë nuk është deklaruar, apo të ketë bërë ndonjë vërejtje, kështu që gjykata këtë provë të ekspertizës e vlerësoi si profesionale dhe të pa anshme, pasi e njëjta është mbështetur të në të dhënat kadastrale që ekzistojnë në kadastrë dhe është e përputhshme, me ekspertiza të më hershme gjeodezike.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, kemi të bëjmë me dy Aktvendime të Kuvendit Komunal në Prishtinë, që ka numër të njëjtë 30/63 dhe 30/64, i pari është më dt. 24.01.1964, ndërsa i dyti është më dt. 10.04.1964, ashtu që sipas vendimit të dytë T I ju është dhënë ngastra kadastrale nr., me sipërfaqe si më lartë .

Gjykata bazuar në Aktvendimin e Kuvendit Komunal në Prishtinë, Komisioni për arondime nr. 30/64, dt. 10.04.1964, vërtetoi faktin se nuk është anuluar fare Aktvendimi i parë me nr. 30/63, dt. 24.01.1964, por është shënuar jashtë dispozitivit dhe arsytimit të aktvendimit 30/64, se ky aktvendim e zëvendëson, aktvendimin nr. 30, më dt.24.01.1964. Ky shënim në aktvendim është i datës dt. 10.04.1964 dhe është vënë në anën e djathtë të faqes së parë përball ku është shënuar emri Kuvendi Komunal Prishtinës, Komisioni për arondime nr. dhe data e vendimit, dhe është shënuar emri S. D .

Personat të cilët e kanë nënshkruar, Aktvendimin nr. 30, /63, dt. 24.01.1964, është nënshkruar nga Kryetari i Komisionit D B, ndërsa në aktvendimin e dytë Kryetari i Komisionit D B, nuk e ka nënshkruar, por është nënshkruar nga Sekretari i Sekretariatit për Ekonomi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës D V R.

Në praktikën juridike nuk ka ndonjë rastë , që të shënohet jashtë diapozitivit të vendimit se vendimi i më vonshëm, e zëvendëson vendimin e më hershëm, pa u sqaruar se a’ zëvendësohet në tërësi apo pjesërisht, dhe pa u anuluar vendimi i parë. Pastaj, nënshkruesi i Aktvendimit që është lëshuar nga i njëjti organ Kuvendi Komunal, Komisioni për Arondime si në të parin dhe të dytin nuk janë persona të njëjtë, pastaj në aktvendimin e dytë nuk është nënshkruar fare në

hyrje të tije, personi S. D që është shënuar emri i tij, pa u ditur pozita e të njëjtit, gje gjësisht a' ka pasur autorizim për të ndërhyrë në aktvendim.

Gjykata vlerëson se paraardhësi i paditësve i ndjeri T I është dashur që këtë situatë juridike ta sqaron me Kuvendin e Komunës së Prishtinës , gjatë kohës sa ka qenë në jetë, dhe si duket mu për shkak të paqartësisë së vlefshmërisë së Aktvendimit të dytë nga baza e të cilin kërkon pronësinë, ai nuk ka arritur ta regjistrojë të drejtën e vetë pronësore, që do të thotë aktvendimi i dytë është një provë e dyshimtë për shkak të ndërhyrjeve në aktvendim, gjykata nuk mund ta pranoj si provë të vlefshme.

Gjykata vlerëson se sikur të kishte qenë aktvendimi nr. 30/64, dt. 10.04.1964, si i vlefshëm, pala do ta kishte regjistruar të drejtën e pronësisë gjatë kohës sa ka qenë në jetë .

Pastaj në mungesë të dokumentacionit të plotë, duke ofruar si provë vetëm aktvendimin e dytë, paraardhësi i paditësit arrin ta regjistroj pronën në Zyrën e Kadastrit në Komunën e Prishtinës, pas luftës në Kosovë, por në vitin 2014, AKP-ja, me kërkesë drejtuar të njëjtin institucion, Zyra e Kadastrit në Prishtinë, bënë rikthimin gjendjes së mëparshme .

Gjykata vlerëson se Aktvendimi i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 30/64, dt. 10.04.1964, ashtu si është hartuar nuk paraqet bazë juridike që paditësit ta përdorin si akte të vlefshëm juridik (titull juridik) për fitimin e drejtës së pronësisë, për arsye të dhëna si më lartë në arsyetim.

Në rastin konkret kundërshtimet e AKP-së në pretendimet e saj ndaj kërkesës pronësore të paditësve janë të bazuara, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, kështu që për këtë arsye edhe është refuzuar kërkesa pronësore .

Prandaj bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe juridike në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti heqë shpenzimet e veta, të procedurës, pasi paditësi ato nuk i kërkoj .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimit. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hasim Sogojeva , Gjyqtar Kryesues

Murat Hulaj , Gjyqtare anëtarë

Asllan Krasniqi , Gjyqtar anëtarë